

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm
Internal Audit Knowledge
Elements**

B1

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test.

Data 30.10.2021

CONTENT / PËRMBAITJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

1. Sipas Nenit 404 'Vlerësimi i menaxhmentit për kontrollin e brendshëm' të Aktit të ShBA-së Sarbanes-Oxley, vlerësimi dhe pohimi i mjedisit të kontrollit të një organizate duhet të fokusohet në cilën prej këtyre?

- A. Kontrollat e integruara.
- B. Kontrollat e veçanta.
- C. Kontrollat e buta.
- D. Kontrollat e vështira.

2. Programet efektive të alarmuesve me fishkëllimë (whistle-blower) mund të ndihmojnë organizatat të plotësojnë kërkesat e Nenit 301 të Komitetit të Auditimit të Aktit Sarbanes-Oxley. Cila nga të mëposhtmet nuk është një element i programit të alarmuesve me fishkëllimë (whistle-blower)?

- A. Grumbullimi i shqetësimeve të punonjësve.
- B. Përmirësimi i komunikimit të brendshëm.
- C. Grumbullimi i informatave rreth çështjeve të reja.
- D. Përmirësimi i komunikimit të jashtëm.

3. Lidhur me investimin e ndërgjegjshëm shoqëror, koncepti i shqyrtimit shoqëror është:

- A. Duke mos u përdorur më nga firma investuese.
- B. Duke u përdorur nga disa firma në mënyrë pozitive ose në mënyrë negative.
- C. Duke mos u praktikuar në jetën reale, përveç në klasë.
- D. Një tregti midis performancës sociale dhe performancës ekonomike.

4. Reflektimi i pikëpamjeve të shoqërisë mbi etikën e kodifikuar është pjesë e cilës prej të mëposhtmeve në aspektin e qytetarisë së korporatave?

- A. Përgjegjësia etike.
- B. Përgjegjësia ekonomike.
- C. Përgjegjësia ligjore.
- D. Përgjegjësia filantropike.

5. Disa korporata fitimprurëse përpiqen të bëjnë të gjitha nga të mëposhtmet, përveç:

- E. Të bëjnë fitim.
- F. Të zbatojnë ligjin.
- G. Të dhurojnë para dhe prona
- H. Të jenë etikë.

6. Gjoni, Drejtor i Përgjithshëm i "Dyqanit të Riparimit të Makinave Gjon", dëshiron të dijë më shumë për 5 punëtorët e lënduar nga 30 punonjësit e tij. Një lëndim kishte të bënte me shtrembërim dore, që ka një probabilitet prej 0.06. Një lëndim tjetër ishte shtrembërim i kurrizit me një probabilitet prej 0.07. Një tjetër ishte mbi-inhalimi i një substance të rrezikshme me një probabilitet prej 0.02. Dy të tjerët ishin lënduar pas rrëshqitjes dhe rrëzimit me një probabilitet prej 0.13. Nëse shumat e humbjeve nga lëndimet ishin 700€, 3,000€, 2,500€, 950€ dhe 1,000€ përkatësisht, cila është vlera e pritshme e humbjes nga lëndimet e një punonjësi për atë vit?

- A. 500.50€
- B. 432.00€
- C. 555.50€

D. 513.50€

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

7. Të gjitha kushtet e mëposhtme sugjerojnë llojet e situatave ku vetsigurimi nga një biznes është i mundur dhe i realizueshëm, përveç:

A. Objektet në rrezik nuk i nënshtrohen shkatërrimit të njëkohshëm.

B. Firma duhet të administrojë planin e vetsigurimit me personelin ekzistues nga brenda.

C. Firma ka të dhëna të sakta ose ka qasje në statistika të kënaqshme në lidhje me probabilitetin e humbjes.

D. Firma është në gjendje të kënaqshme financiare.

13. Një kompani e madhe hapësinore është e organizuar në atë mënyrë që linjat vertikale dhe horizontale të autoritetit janë të kombinuara. Sipas kompanisë, kjo strukturë organizative është më e favorshme për përfundimin e projekteve të mëdha. Zgjidhni formën organizative të përdorur nga kjo kompani:

A. Linja dhe stafi.

B. Matricë.

C. Funksionale.

D. Burokratike.

9. Për të vlerësuar humbjet që mund të ndodhin kur një kërcënim është realizuar ose një dobësi është ekspluatuar, cila nga kategoritë e mëposhtme të humbjes i ofron menaxhmentit mjetet më të mira për të vlerësuar humbjet e tyre të mundshme?

A. Ndodhja e njëhershme e humbjes, humbja aktuale.

B. Humbja e pritshme, humbja katastrofike.

C. Humbja katastrofike, humbja aktuale.

D. Humbja e pritshme, ndodhja e njëhershme e humbjes.

10. Cila nga atributet e mëposhtme të departamentit të auditimit të brendshëm mund të pengojë zbatimin e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes (ERM) në organizatën e auditorit?

I. Qasja e auditimit e bazuar në kontroll.

II. Përdorimi i mjeteve tradicionale të auditimit.

III. Roli i konsulentit.

IV. Aftësitë për moderator.

A. I dhe II.

B. II dhe III.

C. I dhe IV.

D. III dhe IV.

11. Menaxhimi i rrezikut ka evoluar nga cila prej të mëposhtmeve?

A. Hulumtimi i operacioneve.

B. Teoria e vendimeve.

C. Menaxhimi i sigurimeve.

D. Shkenca e menaxhmentit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

12. Sa i përket kornizës së menaxhimit të burimeve të ndërmarrjes (ERM), kostoja e financimit të rrezikut është:

- A. Kosto marginale.
- B. Kosto e mundësisë.**
- C. Kosto mesatare.
- D. Kosto e interesit.

13. Cili lloj i veçantë i strukturës organizative ka të ngjarë të ketë probleme të unitetit të komandës nëse nuk ka komunikim të shpeshtë dhe gjithëpërfshirës midis menaxherëve të ndryshëm funksionalë dhe të projektit?

- A. Linja dhe stafi.
- B. Njësia strategjike e biznesit.
- C. Centralizuar.
- D. Matricë.**

14. Shumë organizata bëjnë përpjekje të përbashkëta për të siguruar që titujt e pozitave të punës të mos kenë konotacione negative. Arritja e një titulli të punës që perceptohet si prestigjioz adreson cilën nga nevojat e mëposhtme?

- A. Fiziologjike.
- B. Respektit.**
- C. Dashurisë.
- D. Sigurisë.

15. Në përgjithësi, siç rriten në madhësi organizatat, strategjitë e tyre:

- A. Bëhen më ambicioze dhe ato shpesh zgjerojnë aktivitetet e tyre brenda industrisë së tyre.**
- B. Fokusohen në integrimin vertikal dhe strukturat e tyre rrjedhimisht bëhen më të centralizuara.
- C. Ndryshojnë nga fokusi në një sërë produktesh të ndryshëm në fokusin në një linjë të vetme produktesh.
- D. Ndiqen dhe përcaktohen nga strukturat e tyre të brendshme.

16. Cila nga mediumet e mëposhtme ka vlerën/pasurinë më të ulët të kanaleve të komunikimit?

- A. Bisedat telefonike.
- B. Komunikimet ballë për ballë.
- C. Video konferenca.
- D. Tabelat e shpalljeve.**

17. 'Çmimi i shitjes = Kostoja për njësi + fitimi i dëshiruar' përfaqëson cilën nga metodat e mëposhtme e çmimeve?

- A. Maksimizimi i fitimit.
- B. Caktimi i çmimit të bazuar në kërkesë.
- C. Caktimi i çmimit të bazuar në kthimin e synuar.**
- D. Marzha standarde.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

18. Cila nga strategjitë e mëposhtme të çmimeve ndiqet në fazën e hyrjes të ciklit të jetës së produktit?
- A. Çmimi elastik.
 - B. Çmimet e numrave të çuditshëm.
 - C. Çmimet vjelëse (shkulëse).
 - D. Çmimet e larta / të ulëta.
19. Auditorët veprojnë në organizata në të cilat menaxhmenti është në proces të ri-inxhinierimit me theks të veçantë në teknikat e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë. Në përpjekjen e tyre për të rritur efikasitetin në përpunim, shumë nga procedurat tradicionale të kontrollit janë duke u fshirë nga struktura e kontrollit të organizatës. Si pjesë e këtij ndryshimi, menaxhmenti është:
- A. Duke vendosur theks më të lartë në monitorimin e aktiviteteve të kontrollit.
 - B. Duke bërë supozime të ndryshme mbi performancën njerëzore dhe natyrën e motivimit njerëzor për dallim prej asaj që ishte bërë sipas teknikave tradicionale të kontrollit.
 - C. Duke vendosur theks më të lartë në vetë-korrigjimin e aktiviteteve të kontrollit dhe automatizimin e procesit.
 - D. Duke bërë të gjitha të mësipërmet.
20. Për të arritur shpërblimin e të konsideruarit si 'zgjerim i klienteles së kompanisë', një tregtar biznesi duhet të jetë në gjendje të:
- A. Shes produktet e tij me kosto më të ulët se sa konkurrentët.
 - B. Përbushë kërkesat e cilësisë, shpërndarjes, shërbimit dhe informacionit.
 - C. Iu përgjigjet kërkesave për çmime më të ulëta.
 - D. Arrijë kompromis për kohën e kaluar me menaxhimin e lartë të klientit.
21. Analiza e furnitorit duhet të bëhet:
- I. Në baza periodike.
 - II. Kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në faktorët e vlerësimit.
 - III. Kur ndodhin ndryshime të shpeshta në vendndodhjen e furnitorit.
 - IV. Sipas bazave të kërkuar nga furnitori.
- A. Vetëm I.
 - B. Vetëm II.
 - C. I dhe II.
 - D. III dhe IV.
22. Në lidhje me Teorinë e Kufizimeve në operacione, cila nga të mëposhtmet përdoret për të rregulluar çmimin e produktit për të pasqyruar më mirë vlerën e përdorimit të produktit të burimit të 'fytëve të ngushta'?
- A. Marzha e marketingut për orë të burimit me 'fyt të ngushtë'.
 - B. Margjina e kontributit për orë të burimit me 'fyt të ngushtë'.
 - C. Marzha e prodhimit për orë të burimit me 'fyt të ngushtë'.
 - D. Marzha e kontabilitetit për orë të burimit me 'fyt të ngushtë'.
23. Për të bindur dhe influencuar njerëzit, menaxherët lidhen me të tjerët duke përdorur:
- A. Një manual politikash.
 - B. Simbolet, metaforat dhe tregimet.

- C. Faktet dhe figurat statistikore.
- D. Rregullat dhe rregulloret.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

24. Një auditor i brendshëm dyshon për mashtrim në departamentin e blerjes. Me kë duhet të komunikojë auditori fillimisht?

- A. Me bordin e drejtorëve.
- B. Me komitetin e auditimit.
- C. Me nënkryetarin e blerjes.
- D. Me menaxherin e auditimit.

25. Nëse një firmë është e decentralizuar dhe ka një rrjet të zyrave të pavarura në çdo rajon me pak ose aspak hierarki formale, cilën strukturë të nivelit të biznesit ka të ngjarë të ketë?

- A. Strukturë funksionale.
- B. Strukturën e matricës së projektit.
- C. Strukturën rrjet.
- D. Strukturën e produktit / tregut.

33. Një ripërdorim i fjalëkalimit të sistemit operativ të përdoruesit për autentikimin paraprak nuk duhet të praktikohet në vendosjen e cilit prej produkteve të mëposhtme të autentikimit të enkriptimit të deponimit?

- A. Kodimi me disk të plotë.
- B. Kodimi i vëllimit.
- C. Kodimi i diskut virtual.
- D. Kodimi i dosjeve dhe / ose kodimi i direktorumeve.

27. Cila nga të mëposhtmet është deklarata më e mirë për përshtatshmërinë organizative?

- A. Përshtatshmëria organizative lehtëson ndarjen e burimeve.
- B. Përshtatshmëria organizative nxit komunikimin.
- C. Përshtatshmëria organizative i transferon njohuritë dhe aftësitë.
- D. Përshtatshmëria organizative i bënë organizatat kompatible.

28. Në matricën e Grupi Këshillues në Boston (BCG Matrica), 'Pikëpyetjet' kanë të bëjnë me cilën nga të mëposhtmet?

- A. Treg të ri me rritje të lartë dhe pjesë të ulët të tregut.
- B. Treg të ri me rritje të ulët dhe pjesë të lartë të tregut.
- C. Treg të ri me rritje të ulët dhe pjesë të ulët të tregut.
- D. Treg të ri me rritje të lartë dhe pjesë të lartë të tregut.

29. Cila nga të mëposhtmet do të jetë e dobishme gjatë gjithë procesit në metodologjinë Sigma gjashtë (Six sigma)?

- A. Hartimi i procesit 'Siç është'.
- B. Hartimi i procesit "Duhet të jetë".
- C. Hartimi i procesit "Mund të jetë".
- D. Hartimi i procesit "Ndoshta është".

30. Cila nga të mëposhtmet është një karakteristikë e menaxhimit total të cilësisë (TQM)?

- A. Menaxhimi sipas objektivave (MBO).
- B. Trajnimet në vendin e punës nga punëtorët e tjerë.

C. Cilësia sipas inspektimit përfundimtar.

D. Edukimi dhe vetë-përmirësimi.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** Nga 2 pikë secila

31. Në vitet pas mesit të përdorimit të një pasurie të zhvlerësueshme, cila nga metodat e mëposhtme të zhvlerësimit do të rezultojë në shpenzimet më të larta të zhvlerësimit?

A. Zhvlerësimi i shumës së shifrave të viteve.

B. Zhvlerësimi i saldo zbritëse.

C. Zhvlerësimi i saldosh zbritëse të dyfishtë.

D. Zhvlerësimi drejtvizor (linear).

32. Nga pikëpamja e kontrollit të qasjes, ndarja e detyrës (SOD) nuk lidhet me cilën prej të mëposhtmeve?

A. Sigurinë.

B. Besueshmërinë.

C. Mashtrimin.

D. Mbrojtjen.

33. Rreziku i vetvetishëm lidhet me qasjen logjike që është e vështirë për t'u parandaluar ose zvogëluar, por mund të identifikohet nëpërmjet rishikimit të gjurmëve të auditimit. Me cilën nga llojet e mëposhtme të qasjes, ky rrezik është më shumë i lidhur?

A. Qasja e autorizuar e përdorur në mënyrë të duhur.

B. Qasja e autorizuar e keqpërdorur.

C. Qasje e paautorizuar e pasuksesshme.

D. Qasje e paautorizuar e suksesshme.

34. Koncepti i pikës së elasticitetit të reklamave zbulon:

A. Ndryshimin në përqindje të kërkesës pas një ndryshimi në reklamim.

B. Ndryshimin në përqindje në sasinë e kërkuar pas një ndryshimi në reklamim.

C. Ndryshimin në përqindje në reklamat pas një ndryshimi në sasinë e kërkuar.

D. Ndryshimin në përqindje në reklamat pas ndryshimit të kërkesës.

35. Cila nga politikat e kontrollit të qasjes në vijim trajton përdoruesit dhe pronarët si të njëjtë?

A. Politika e kontrollit diskrecional të qasjes (DAC).

B. Politika e kontrollit të detyrueshëm të qasjes (MAC).

C. Politika e kontrollit të qasjes bazuar në rol (RBAC).

D. Listat e kontrollit të qasjes (ACLs).

36. Cila nga muret mbrojtëse (firewalls) në vijim është më e sigurtë?

A. Muret mbrojtëse për filtrimin e pakove.

B. Muret mbrojtëse me nën-rrjet të mbrojtur.

C. Muret mbrojtëse me nën-rrjet të ekranit.

D. Muret mbrojtëse me portë të rrjetit të dyfishuar.

37. Nënshkrimet digjitale nuk mund të ofrojnë cilën prej shërbimeve të mëposhtme të sigurisë?

A. Konfidencialitetin.

B. Autentifikimin.

- C. Integritetin.
- D. Mos mohimin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë. Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

38. Cila nga parimet e mëposhtme të sigurisë nuk funksionon në mënyrë efektive?
- A. Siguria me rregulla.
 - B. Siguria me errësim.
 - C. Refuzimi i paracaktuar.
 - D. Fshehja e të dhënave.
39. Cila nga të mëposhtmet krijon disa zona të çmilitarizuara (DMZ) të pavarura në një rrjet?
- A. Metodot e shumta të kodimit.
 - B. Muret mbrojtëse (firewalls) me shumë baza.
 - C. Modulet kriptografike me shumë çip.
 - D. Ndërruesit me shumë shtresa.
40. Për të siguruar mjedise me shumë përdorues dhe shumë platforma, mbrojtja e pajisjeve të komunikimit ndërlidhës është pjesë e cilës prej të mëposhtmeve?
- A. Kontrolleve të menaxhmentit.
 - B. Kontrolleve teknike.
 - C. Kontrolleve fizike.
 - D. Kontrolleve procedurale.
41. Nga këndvështrimi i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes, të gjithë nga të mëposhtmit mund të mbikëqyrin aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, përveç:
- A. Udhëheqësi financiar.
 - B. Kryeshefi Ekzekutiv.
 - C. Shefi ekzekutiv i auditimit.
 - D. Shefi i riskut.

42. Informatat e mëposhtme janë pjesë e një Bilanci Vërtetues të pakorrigjuar, për një kompani që lëshon pajisje me qira, më 31 dhjetor 2012:

Paraja e gatshme	17,400€
Parapagimi i sigurimit	3,600€
Pasuritë Jo-Qarkulluese	180,000€
Zhvlerësimi i akumuluar	32,000€
Llogaritë e pagueshme	12,000€
Aksionet e zakonshme	60,000€
Fitimet e mbajtura	38,000€
Të hyrat nga qiraja	171,000€
Shpenzimet e pagave	80,000€
Shpenzimet e shërbimeve tjera	14,000€

Më 1 tetor 2012, kompania pagoi 18,000€ për të ripërtirë politikën e saj të sigurimit për një periudhë tre-vjeçare që fillon në atë datë. Ky transaksion nuk është regjistruar. Pagat në vlerë prej 1,700€ kanë ndodhur por nuk janë paguar për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2012. Më 31 dhjetor 2012, saldo e Parasë së Gatshme sipas Gjendjes Bankare ishte 12,000€. Çeqet e papaguara arritën në 6,900€. Interesi prej 40€ është kredituar në llogarinë bankare të kompanisë gjatë dhjetorit, por ende nuk është regjistruar në librat e kompanisë. Regjistrimi i kërkuar i rregulluar më 31 dhjetor 2012, që lidhet me paga është:

- A. Debi: Shpenzimet e pagave 1,700€ / Kredi: Të hyrat nga pagat 1,700€.

- B. Debi: Detyrimi i pagave 1,700€ / Kredi: Shpenzimet e pagave 1,700€
 C. Debi: Shpenzimet e pagave 1,700€ / Kredi: Detyrimi i pagave 1,700€
 D. Debi: Të hyrat nga pagat 1,700€ / Kredi: Detyrimi i pagave 1,700€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

43. Gjatë vitit të parë të operimit, një ekip sportiv profesionist kishte shitje paraprake të biletave prej 3,000,000€ për lojërat që do të luhen gjatë periudhës që fillon më 1 nëntor të vitit të parë dhe që përfundon më 30 prill të vitit të dytë. Dhjetë lojë luhen çdo muaj. Bazuar në këtë informacion, kompania duhet të:

- A. Raportoj të hyra të shtyra në vlerë prej 2,000,000€ në Bilancin e Gjendjes më 31 dhjetor të vitit të parë.
 B. Raportoj të hyra të shtyra në vlerë prej 3,000,000€ në në Bilancin e Gjendjes më 31 dhjetor të vitit të parë.
 C. Raportoj të hyra prej 3,000,000€ në Pasqyrën e të Ardhurave për vitin e parë.
 D. Raportoj të hyra prej 1,000,000€ në Pasqyrën e të Ardhurave për vitin e dytë.

44. Më 1 prill 2012, kompania ABC shkëmbu 10,000 aksione të zakonshme me një vlerë totale prej 20,000€ për një pjesë të tokës në pronësi të kompanisë XYZ. Aksionet ishin aksione të thesarit të cilat kompania ABC i kishte blerë vite më parë në vlerë prej 35,000€ dhe që kishin një vlerë tregu prej 44,000€ më 1 prill 2012. Toka kishte një vlerë të regjistruar në librat XYZ prej 28,000€. Cila prej vlerave të mëposhtme përfaqëson koston e tokës që duhet të regjistrohet nga kompania ABC?

- A. 20,000€
 B. 28,000€
 C. 35,000€
 D. 44,000€

45. Një kompani bleu një makinë për 700,000€. Vlera e mbetur ishte 40,000€ dhe makina u zhvlerësua duke përdorur metodën drejtvizore. Makina u shit më 31 dhjetor 2012. Zhvlerësimi i akumuluar në lidhje me makinën ishte 495,000€ në atë datë. Kompania raportoi një fitim kapital nga shitja e makinës në vlerë prej 75,000€ në pasqyrën e saj të të ardhurave për vitin fiskal që mbaron më 31 dhjetor 2012. Sa ishte çmimi i shitjes së makinës?

- A. 280,000€
 B. 240,000€
 C. 205,000€
 D. 115,000€

46. Një kompani konglomerate bleu 100% të pasurive neto të një kompanie të synuar për 900€, kesh. Bilanci i Gjendjes i kompanisë së synuar para blerjes është paraqitur më poshtë.

Kompania e synuar (në datën e blerjes)

	Paraja e gatshme	LI/A (Klientët)	Stoqet	Prona, Fabrika dhe Pajisjet	Total Pasuritë	Detyrimet afatshkurtra	Aksionet e Zakonshme	Fitimi i Mbajtur	Total Ekuiteti dhe Detyrimet
Vlera në libra	100€	200€	150€	600€	1,050€	200€	200€	650€	1,050€
Vlera e drejtë	100€	200€	200€	400€	900€	200€			

Shuma e emrit të mirë (goodwill) që do të regjistrohet nga kompania konglomerate në lidhje me blerjen e kompanisë së synuar do të ishte:

- A. (200€).

B. 50€

C. 200€

D. Asnjëra nga të mësipërmet.

**Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!** **Nga 2 pikë secila**

47. Gjatë vitit 2012, llogaritë e Bilancit të Gjendjes së një kompanie u rritën me shumën e mëposhtme:

Pasuritë	180,000€
Detyrimet	50,000€
Aksionet e zakonshme	105,000€

Fitimi neto për vitin 2012 ishte 42,000€. I vetmi ndryshim tjetër në fitimet e mbajtura ishte për deklarimin e dividendëve në para të gatshme. Shuma e dividendëve të deklaruar ishte:

A. 2,000€

B. 17,000€

C. 33,000€

D. 67,000€

48. Një kompani shet në kushtet e 2/10 net 60. Ajo shet 1000 njësi në ditë me një çmim prej 10€ për njësi. Në 60% të shitjeve, klientët marrin zbritje në para të gatshme. Në pjesën e mbetur prej 40% të shitjeve, klientët paguajnë, mesatarisht, brenda 70 ditëve. Cili do të ishte ndikimi në saldon e llogarive të arkëtueshme nëse firma fillon të aplikoj një politikë më agresive të mbledhjes së borxheve dhe është në gjendje të zvogëlojë periudhën mesatare të pagesës në 60 ditë për ata konsumatorë që nuk marrin zbritjen në kesh? (Supozoni se niveli i shitjeve nuk ndikohet nga ndryshimi i politikës.)

A. Zvogëlim për 4,000€

B. Zvogëlim për 40,000€

C. Zvogëlim për 240,000€

D. Zvogëlim për 280,000€

49. Më 1 janar 2012, një kompani bleu një pasuri bimore për 300,000€. Duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit për jetëgjatësinë prej 10 vjetësh dhe pa vlerë të mbetur, kompania regjistroi zhvlerësimin prej 30,000€ për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Vlera e drejtë e pasurisë më 31 dhjetor 2012 është 310,000€. Bilanci i Gjendjes (Pasqyra e Pozitës Financiare) e përgatitur më 31 dhjetor 2012, do të:

A. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si emër të mirë (goodwill).

B. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si pjesë e impianteve dhe pajisjeve.

C. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si kapital vlerësues.

D. Të mos raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra.

50. Një garanci e shprehur brenda kuptimit të Kodit Unik Tregtar është përshkruar më së miri me cilën nga të mëposhtmet?

A. Një mostër.

B. Një përshkrim.

C. Një premtim.

D. Të gjitha të mësipërmet.

Fletë për ushtrime – mos i paraqitni zgjidhjet këtu!

